

VENDIM
Nr. 28, datë 10.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 10.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (D) 2025, të Regjistrat Themeltar që u përket:

KËRKUES: Dedë Nika, përfaqësuar nga avokati Atmir Mani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Mjedisit (ish-Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave), përfaqësuar nga sekretarja e përgjithshme Ledina Beqiraj Agalliu.

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër, në mungesë.

OBJEKTI: Rihapja dhe rivlerësimi i çështjes për vendimin nr. 33, datë 26.2.2021, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 280, datë 10.6.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Dedë Nika (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mjedisit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Shkodër, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi prej vitit 1992, ka qenë në marrëdhënie pune, të rregulluar sipas kontratës së punës, në detyrën e inspektorit në Parkun Kombëtar të Thethit në Ndërmarrjen e Shërbimit Pyjor, Shkodër (*NSHP*). Me urdhrin nr. 409, datë 19.12.2005 (*urdhri i parë i largimit nga detyra*) të drejtorit të NSHP-së, Shkodër është urdhëruar largimi nga detyra i kërkuarit, pasi, sipas punëdhënëses, gjatë ushtrimit të detyrës i kishte shkaktuar dëm institucionit. Për këtë arsye, punëdhënësjë, NSHP-ja, Shkodër, ka paraqitur edhe kallëzim penal, duke e akuzuar kërkuarin për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar në nenin 248 të

Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 6.6.2006, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e hetimeve, pasi fakti nuk parashikohej si vepër penale. Sipas Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dëmi i konstatuar edhe nga grupi i ekspertizës ishte i një shkalle të vogël, për të cilën nga drejtoria e pyjeve Shkodër janë marrë masa administrative.

2. Urdhri i parë i largimit është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila, me vendimin nr. 58, datë 17.1.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi ka rezultuar se urdhri ishte anuluar nga drejtori i NSHP-së, Shkodër dhe kërkuesit i ishte ofruar paga, por ai e kishte refuzuar. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 291, datë 25.6.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2009-117, datë 13.2.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Në vijim, me propozim të drejtorit të NSHP-së, Shkodër, dhe me urdhrin nr. 189 prot., datë 14.4.2006, të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kërkuesi është liruar nga detyra me motivacionin se ai nuk kishte marrë masa për ndërprerjen e prerjeve të paligjshme të pyjeve (*urdhri i dytë i largimit nga detyra*).

4. Gjithashtu, pas verifikimeve të kryera nga komisioni i ngritur nga NSHP-ja, Shkodër, për marrjen në dorëzim të bazës materiale, me të cilën ishte pajisur kërkuesi, me shkresën nr. 47 prot., datë 5.2.2007 (*shkresa nr. 47, datë 5.2.2007*) të këtij institucioni, ai ishte njoftuar se ishte debitor ndaj NSHP-së, Shkodër për dëmet e shkaktuara në pajisje (motosharrë, motoçikletë) që kishte pasur në ngarkim dhe se, për këtë shkak, nuk mund të merrte pagat e tre muajve të fundit.

5. Në këtë situatë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për kundërshtimin e shkresës nr. 47 prot., datë 5.2.2007 të NSHP-së, Shkodër dhe të urdhrit për largimin nga detyra, duke kërkuar rikthimin në punën e mëparshme, pagimin e pagës deri në datën e rikthimit në punë, si dhe pagesën e pagës së tre muajve në vlerën 50.319 lekë që i ishin mbajtur pa të drejtë nga punëdhënësjja.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 698, datë 30.3.2007, ka vendosur pranimin e padisë, anulimin e urdhrin nr. 189 prot., datë 14.4.2006, të largimit nga detyra, konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve së punës pa shkaqe të justifikuara, detyrimin e punëdhënëses për të rikthyer kërkuesin në detyrën e mëparshme dhe për të paguar pagën që ka pasur muajin e fundit të punës, deri në përmbushjen e detyrimit për rikthimin e tij në punë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur edhe anulimin e shkresës nr. 47 prot., datë 5.2.2007, pasi nuk është provuar përgjegjësia e kërkuesit për dëmin e pretenduar, si dhe ka përcaktuar detyrimin e punëdhënëses për t’i paguar atij pagat e papaguara në vlerën 50.319 (pesëdhjetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

7. Pas ankimit të NSHP-së, Shkodër dhe apelit kundërshtues të kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 468, datë 30.10.2007, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 698, datë 30.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes, pasi kërkuesi kishte paraqitur kërkesëpadi, duke përcaktuar si bazë ligjore nenin 324 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), dispozitë e cila lidhet me mosmarrëveshjet administrative dhe se kërkuesi nuk kishte paraqitur kërkesë për të ndryshuar bazën ligjore të padisë.

8. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-757 (121), datë 8.3.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 468, datë 30.10.2007, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe se gjykata e apelit ka anashkaluar rregullimet e KPC-së, Kodin e Punës dhe praktikën gjyqësore të rasteve të ngjashme.

9. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 280, datë 10.6.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 698, datë 30.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por me ndryshimin duke detyruar punëdhënësin të paguajë në favor të kërkuesit 2 muaj paga, si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës në punë, 3 muaj

paga, si dëmshpërblim për mosrespektimin e afatit për zgjidhjen e kontratës në punë, 13 paga 15-ditëshe, si shpërblim për vjetërsinë në punë, 1 vit pagë, si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës në punë dhe rrëzimin e kërimit për kthimin në punën e mëparshme, duke arsyetuar se instituti i kthimit në punë jo vetëm teorikisht nuk është pranuar, por edhe praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrim tjetër juridik. Gjykata e apelit në rigjykim ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e vendimit unifikues nr. 7/2011 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit e drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pas rekursit të kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk ishin ngritur shkaqe të bazuara në nenin 472 të KPC-së përpara ndryshimeve të vitit 2017.

10. Në datën 18.1.2021, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual me objekt kundërshtimin e vendimeve nr. 280, datë 10.6.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 33, datë 26.2.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke arsyetuar se kërkuari nuk legjitimohej *ratione temporis*, pasi shënimi i sekretarisë së Gjykatës së Lartë “*Tërhequr në datën 14.1.2021*” në kopjen e vendimit të asaj gjykate dhe të depozituar nga kërkuari në Gjykatë nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht prej tij për efekt të gjyqimit kushtetues.

11. Pas vendimit të Kolegjit të Gjykatës, kërkuari i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi Gjykata nuk kishte pranuar për shqyrtim kërkesën për shkak të zbatimit të afatit të ri ligjor 4-mujor. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 14.1.2024 (*Case of Ibrahimi and other vs Albania*), ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, pasi kërkuarit i ishte cenuar e drejta për t’iu drejtuar Gjykatës.

12. Pas vendimit të GJEDNJ-së, kërkuari, në datën 2.5.2025, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit, e cila është regjistruar në datën 19.5.2025, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak në datën 16.7.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës, rihapjen e procesit dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në pranimin e kërkesës për rihapje procesi, Kolegji ka vlerësuar se kërkesa përmbushte kriterin *ratione temporis* të parashikuar në nenin 71, shkronja “c”, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare (nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë). Në rastin konkret, vendimi i GJEDNJ-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.2.2025 dhe kërkuari i është drejtuar asaj në datën 2.5.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71, shkronja “c”, pika 4, i Ligjit Organik të Gjykatës. Gjithashtu, edhe pretendimet *ratione materiae* janë në juridiksionin dhe në kompetencën e Gjykatës.

13. Gjykata për subjektet e interesuara të thirrura në këtë gjykim kushtetues evidenton se emërtimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që ka qenë palë në procesin gjyqësor, ka ndryshuar në Ministria e Mjedisit. Ndërsa NSHP-ja Shkodër është shkruar në vitin 2016 dhe lista e inventarit të këtij institucioni aktualisht është në administrimin e Ministrisë së Mjedisit.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual të datës 18.1.2021, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

14.1 *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarët A. K. dhe L. D. kanë gjykuar edhe më parë të njëjtën çështje, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt. Ata kanë qenë pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Shkodër, që me vendimin nr. 291, datë 25.6.2007, ka vendosur për kërkesën për kundërshtim e urdhrit nr. 409, datë 19.12.2005, të drejtorit të NSHP-së, Shkodër (urdhri i

parë i largimit). Po këta gjyqtarë kanë gjykuar dhe çështjen e kërkuarit objekt i ankimit kushtetues individual, pas kthimit për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër me vendimin nr. 00-2012-757 (121), datë 8.3.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

14.2 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë duhet të funksionojë në kolegje, ndërsa Kolegji Administrativ duhet të ketë në përbërje tre anëtarë. Në rastin e kërkuarit, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në Kolegjin Administrativ të përbërë nga një anëtar, ndërsa anëtarët e tjerë bëjnë pjesë në kolegje të tjera të gjykatës. Përveç kësaj, në vendimin e saj nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, për mospranim rekursi, Gjykata e Lartë jo vetëm që nuk ka respektuar standardet kushtetuese, por edhe ka gabuar rëndë në materie, duke mos përmbushur funksionet e saj si gjykatë ligji.

14.3 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, në shkelje të nenit 142 të Kushtetutës, pasi në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka përmendur si palë paditëse që ka ushtruar rekurs INSIG sh.a. dhe jo kërkuarin, çka e bën këtë vendim jologjik, jo të rregullt në formë, aspak të qartë në përmbajtje dhe të pakuptueshëm. Kjo gjykatë nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e kërkuarit dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha çështjeve. Në vendimin ajo është mjaftuar vetëm me paraqitjen e provave, që provojnë lidhjen mes çështjeve dhe nuk i ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimit të kërkuarit për shkeljen e *parimit të paanshmërisë*, duke e lënë në këtë mënyrë të paarsyetuar vendimin e saj.

14.4 *Së drejtës së aksesit dhe të ankimit*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos u shprehur për asnjë nga pretendimet e rekursit, si dhe duke mos e kaluar çështjen në seancë, ka cenuar të drejtën e kërkuarit për akses, për t'u dëgjuar e për t'u gjykuar. Në kushtet kur e vetmja shkallë ankimi për keqinterpretimin e ligjit ishte Gjykata e Lartë, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, ajo duhej të mbante një qëndrim të shprehur për dispozitat e Kodit të Punës, duke u bërë atyre interpretimin ligjor.

15. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Mjedisit***, në parashtrimet e datës 11.9.2025, ka prapësuar si vijon:

15.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë* nuk është ngritur në nivel kushtetues. Kërkuari nuk ka paraqitur asnjë të dhënë për ndikim në vendimmarrje, por thjesht emra të njëjtë gjyqtarësh dhe kjo nuk është e mjaftueshme për të provuar paragjykimin objektiv.

15.2 Pretendimi për cenimin e *gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar sipas rregullave në fuqi në kohën kur është paraqitur rekursi. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, ka vendosur se për rekursin e paraqitura përpara datës 4.11.2013, do të zbatohen rregullat e vjetra procedurale.

15.3 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos kenë respektuar elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

15.4 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit dhe të ankimit* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe pasi i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në rekurs ka vlerësuar duke arsyetuar qëndrimin e saj në vendim. Vetëm fakti që gjykimi është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk është cenuar asnjë e drejtë procedurale e kërkuarit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për themelin e pretendimeve

16. Gjykata vëren se pretendimet *ratione materiae* të parashtruara nga kërkuari lidhen me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të *parimit të paanshmërisë*, të *gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* dhe të *së drejtës së aksesit*.

17. Gjykata vëren se për pretendimin e cenimit të *gjkimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuksi ka pretenduar se vetëm njëri prej gjyqtarëve i përket Kolegjit Administrativ, ndërsa gjyqtarët e tjerë bëjnë pjesë në kolegjet e tjera. Për këtë pretendim, subjekti i interesuar, Ministria e Mjedisit, ka prapësuar se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar sipas rregullave në fuqi në kohën kur është paraqitur rekursi.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me këtë pretendim, referuar vendimit nr. 47, datë 1.4.2021, të Këshillit të Gjykatës së Lartë është vendosur caktimi i gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si dhe caktimi i gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit kolegji. Bazuar në këtë vendim, në përbërje të Kolegjit Administrativ është caktuar gjyqtari S. S. Po kështu, për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore administrative është caktuar përbërja e dy trupave gjykues me tre gjyqtarë, njëri prej të cilëve ka gjykuar çështjen e kërkuksit. Sipas raportit për veprimtarinë e Gjykatës së Lartë për vitin 2021, rezulton se për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve (9 nga 17), është marrë masa organizative për vijimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore duke krijuar disa trupa gjykues, pavarësisht përkatësisë së gjyqtarit në Kolegji (*shih faqen 4 të raportit të veprimtarisë së Gjykatës së Lartë për vitin 2021*).

20. Për sa më lart, në respektimin e standardeve kushtetuese, Gjykata vlerëson se argumentet janë të lidhura me procesin organizativ të kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe se kërkuksi nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për të provuar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për rrjedhojë pretendimi është haptazi i pabazuar.

21. Pretendimet për cenimin e *parimit të paanshmërisë, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit e të ankimit*, Gjykata vlerëson se hyjnë në juridiksionin kushtetues. Gjykata vëren se argumentet për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* kërkuksi e ka ndërlidhur me cenimin e *së drejtës së aksesit e të ankimit*, duke parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardet kushtetuese për arsyetimin se nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e ngritura në rekurs, për rrjedhojë këto pretendime do të trajtohen së bashku në vijim.

A.1 Për cenimin e parimit të paanshmërisë

22. Kërkuksi ka pretenduar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër dy gjyqtarët A. K. dhe L. D. kanë qenë pjesë e trupit gjykues në gjykimin e çështjes me objekt kundërshtimin e urdhrit të parë nr. 409/2005 për largimin nga detyra (vendimi nr. 291, datë 25.6.2007), po ashtu edhe në gjykimin e urdhrit të dytë nr. 189, datë 14.4.2006 (vendimi nr. 280, datë 10.6.2013).

23. Subjekti i interesuar, Ministria e Mjedisit, ka prapësuar se pretendimet nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuksi nuk ka paraqitur asnjë të dhënë për ndikim në vendimmarrje, por thjesht emra të njëjtë gjyqtarësh dhe kjo nuk është e mjaftueshme për të provuar paragjykimin objektiv.

24. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe gjithashtu testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 35, datë 25.4.2024; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 15, datë 26.3.2012; nr. 12, datë 13.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij, por ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit për çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar për paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimet nr. 25, datë 11.6.2013; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme kushtetuese dhe referuar fakteve konkrete, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit do të vlerësohet në drejtim të testit subjektiv, për bindjen e brendshme të gjyqtarëve, sipas të cilit parimi i paanshmërisë është cenuar, pasi në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Shkodër kanë marrë pjesë gjyqtarët A. K. dhe L. D, të cilët kanë marrë pjesë edhe në gjykimin e parë, në vitin 2007, kur po Gjykata e Apelit Shkodër ka shqyrtuar urdhrin e parë të largimit (vendimi nr. 291, datë 25.6.2007 i Gjykatës së Apelit Shkodër).

28. Gjykata konstaton se në rastin e shqyrtimit të urdhrin të parë të largimit nga detyra Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, sepse kërkuarisi kishte kundërshtuar një urdhrë të anuluar nga punëdhënësjat. Në përfundim, ajo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim, se kërkuarisi kishte kundërshtuar një urdhrë që nuk kishte sjellë pasoja juridike për të, pasi ishte anuluar nga vetë organi që e kishte nxjerrë. Ndërsa me vendimin nr. 280, datë 10.6.2013, Gjykata e Apelit Shkodër (pjesë e trupit gjykues kanë qenë përsëri gjyqtarët A. K. dhe L. D.) ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë që kishte anuluar urdhrin e dytë të largimit nga puna, duke përcaktuar shpërblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, në shkelje të dispozitave të Kodit të Punës. Pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë kërkuarisi e ka ngritur në rekurs. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuarisi jo vetëm nuk e ka ngritur gjatë gjykimit në apel, por nuk ka ofruar asnjë shpjegim ose provë (*shih paragrafin 23, të vendimit nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

29. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pjesëmarrja e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër nuk krijon dyshime për cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi mosmarrëveshjet e shqyrtuara kanë qenë të ndryshme, sepse objekt kundërshtimi kanë qenë dy urdhra të ndryshëm për largimin nga detyra të kërkuarisi. Për më tepër, në rastin e parë, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 291, datë 25.6.2007, nuk e ka gjykuar mosmarrëveshjen në themel, pasi urdhri i largimit nga puna ishte anuluar nga drejtori, duke mos sjellë pasojë juridike për kërkuarisen. Ndërsa në rastin e shqyrtimit të urdhrin të dytë të largimit nga puna, Gjykata e Apelit Shkodër e ka shqyrtuar mosmarrëveshjen në themel, duke vendosur në favor të kërkuarisi, pasi urdhri i

largimit ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

A.2 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

30. Kërkuari ka pretenduar se në kushtet kur e vetmja shkallë ankimi për keqinterpretim të ligjit është Gjykata e Lartë, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, ajo duhet të mbante një qëndrim të shprehur për dispozitat e Kodit të Punës, duke u bërë atyre interpretimin ligjor. Gjykata e Lartë ka përmendur si palë paditëse që ka ushtruar rekurs shoqërinë INSIG sh.a. dhe jo kërkuarin, çka e bën këtë vendim jologjik, jo të rregullt në formë, aspak të qartë në përmbajtje dhe të pakuptueshëm. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit që lidhen me kërkimin për rikthimin në punë dhe cenimin e parimit të paanshmërisë.

31. Subjekti i interesuar, Ministria e Mjedisit, ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe, pasi i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në rekurs, ka vlerësuar duke arsyetuar qëndrimin e saj në vendim. Vetëm fakti që gjykimi është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk është cenuar asnjë e drejtë procedurale e kërkuarit.

32. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa u takon vendimeve të mospranimit të rekursit, në jurisprudencën konstante është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 3.10.2024; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se në vlerësimin e shkaqeve ligjore në rekurs dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, nëse kolegji i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e

katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuar ka marrë përgjigje për pretendimin thelbësor të tij të parashtruar gjatë gjykimit për paligjshmërinë e urdhrat të largimit nga detyra dhe rikthimin e tij në detyrë, sipas parashikimeve ligjore në Kodin e Punës.

36. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, pas vënien në lëvizje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për kundërshtimin akteve për largimin nga detyra, duke kërkuar rikthimin në punën e mëparshme (*shih paragrafin 5 të këtij vendimi*), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pranimin e padisë, anulimin e akteve, konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të justifikuara, detyrimin e punëdhënëses për të rikthyer në detyrën e mëparshme kërkuar. Sipas gjykatës së shkallës së parë, largimi i kërkuar nga detyra është në kundërshtim me nenin 155 të Kodit të Punës, pa shkaqe të arsyeshme dhe duke iu referuar pikës 3 të këtij neni që parashikohen se për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendimin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim, kërkuar, si punonjës i administratës publike, duhet të rikthehet në punë (dispozitë në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës së kërkuar). Ndërsa Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes, pasi kërkuar kishte paraqitur një padi, duke përcaktuar si bazë ligjore nenin 324 të KPC-së, dispozitë që lidhet me mosmarrëveshjet administrative dhe nuk kishte paraqitur kërkesë për të ndryshuar bazën ligjore të kërkesëpadi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-757 (121), datë 8.3.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 468, datë 30.10.2007, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe ka përcaktuar dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërimit për kthimin në punën e mëparshme (*shih paragrafin 9 të këtij vendimi*).

37. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuar, ku kishte ngritur pretendime për: i. cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, të cilit, sikur u trajtua Gjykata e Lartë, i ka dhënë përgjigje (*shih paragrafin 28 të këtij vendimi*); ii. ndërprerjen e marrëdhënies së punës në kundërshtim me nenin 153 të Kodit të Punës dhe rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si punonjës i administratës publike. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-60, datë 27.5.2020, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk janë ngritur shkaqe të bazuara në nenin 472 të KPC-së përpara ndryshimeve të vitit 2017.

38. Për shqyrtimin e themelit të pretendimit, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

39. Sipas njërës qëndrim, duke pasur parasysh natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është vendosur mospranimi i rekursit në dhomën e këshillimit, në të janë listuar shkaqet e parashtruara në recurs dhe në përfundim ka arsyetuar se recursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, që të bënin të cënueshme vendimet e gjykatave të faktit dhe se ato kishin mbështetur vendimmarrjen e tyre në jurisprudencën e vendimeve unifikuese nr. 31/2003 dhe nr. 7/2011 të Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të argumentuar dhe shteruese pretendimit për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, sipas nenit 155 të Kodit të Punës. Për rrjedhojë, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit

gjyqësor. Ato kanë arsyetuar vendimet e tyre bazuar në provat e administruara në gjykim, të shqyrtuara dhe të vlerësuara në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuarit për largimin nga detyra dhe për kërkimin e tij për t'u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, dhe se interpretimi që i ka bërë ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, pasi kërkuari ka marrë përgjigje të arsyetuar për kërkimin e tij. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e vendosura nga Gjykata për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, gabimet materiale të konstatuara në paragrafët 13 dhe 24, ku është cituar si palë paditëse shoqëria INSIG sh.a., e cila nuk është palë në procesin gjyqësor konkret, janë të tilla që nuk cenojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë. Për të gjitha këto arsye, pretendimi i kërkuarit për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar dhe kërkesa duhej të ishte rrëzuar¹.

40. Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se pretendimi i kërkuarit për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i bazuar ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar. Në jurisprudencën kushtetuese, nën dritën e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është vlerësuar edhe çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur gjykatat e faktit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta, merr rëndësi përcaktuese natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuari ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë, Gjykata ka theksuar se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në lidhje me gabimet materiale të konstatuara në përmbajtje të vendimit të Gjykatës së Lartë, pavarësisht se janë të tilla që nuk vënë në dyshim vendimmarrjen, nisur nga rasti konkret, duhet të theksohet se Gjykata e Lartë duhet të jetë e kujdesshme në paraqitjen qoftë edhe të elementeve formale të vendimit, sikurse janë edhe emrat palëve në një proces gjyqësor, për të evituar sa më shumë dyshimet për mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

42. Ndërsa për themelin e pretendimit, pavarësisht natyrës së vendimit të kundërshtuar, të marrë në dhomën e këshillimit dhe respektimit të standardit kushtetues për listimin e shkaqeve të ngritura në rekurs, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk i ka dhënë përgjigje kërkuarit kryesor të kërkuarit për zbatimin e pikës 3, të nenit 155 të Kodit të Punës, sipas të cilit për punëmarrësin në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar ta zbatojë. Duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, ky kërkim thelbësor është i lidhur me të drejtën kushtetuese për punë, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës. Gjykata e Lartë duhet t'i jepte përgjigje kërkuarit nëse pozicioni i tij i punës përfshihej në konceptin e administratës publike. Për më tepër, kur gjykatat e faktit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta për kërkimin për rikthimin në punë. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë, duke mos analizuar çështjen në interpretim të këtij parashikimi ligjor, ka cenuar të *drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*².

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Marjana Semini, Asim Vokshi.

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja.

43. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej numri i kërkuar prej 5 gjyqtarësh për vendimmarrjen për themelin e pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

44. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuarit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.3.2026.

Shpallur më 21.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Asim Vokshi